



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 489/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Fatos Lashi” p.f. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”, me nr. REF-11181-02-28-2019, me vlerë të pritshme të kontratave për 2 vjet 43,593,744 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.

Ankimues: Operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f.
Adresa: Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, K.1, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Instituti i Shëndetit Publik
Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 28.02.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës ”*”, me nr. REF-11181-02-28-2019, me vlerë të pritshme të kontratave për 2 vjet 43,593,744 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.

II.2 Në datën 25.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 02.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Air” sh.p.k. & “Truly Nolen” d.sh.h	34.149 lekë, skualifikuar
2. “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.	43.000 lekë, kualifikuar
3. “Fatos Lashi” p.f.	47.406 lekë, kualifikuar
4. “NRG” sh.p.k.	50.410 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 08.04.2019, operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.Me shkresën nr.76/33 prot datë 15.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6.Në datën 24.04.2019, “Fatos Lashi” p.f ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7.Në datën 03.06.2019, pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës, me anë të Vendimit K.P.P. 334/2019, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si më poshtë vijon:

“1.Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f për procedurën e prokurimit me Nr.REF-11181-02-28-2019, me objekt: “LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, duke e s’kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik”

II.8. Në datën 13.06.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Air” sh.p.k. & “Truly Nolen” d.sh.h	34.149 lekë, skualifikuar
2. “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.	43.000 lekë, skualifikuar
3. “Fatos Lashi” p.f.	47.406 lekë, skualifikuar
4. “NRG” sh.p.k.	50.410 lekë, kualifikuar

II.9. Në datën 13.06.2019, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Fatos Lashi” p.f. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Bazuar ne shkresen e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 3159 prot., date 11.06.2019.”

II.10. Në datën 17.06.2019 operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së, për skualifikimin e ofertës së tij, duke argumentuar si më poshtë vijon:

”[...] Me datë 13.06.2019 nëpërmjet njoftimit në SPE, operatori ekonomik ankimues, njoftohet se është skualifikuar në zbatim të shkresës Nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Të nderuar zotërinj! Shkresa me këtë numër protokolli e nxjerrë nga institucioni juaj epror çfarë ka në përmbajtjen e saj? Minimalisht duhet të dini se nuk kemi të bëjmë me një kontratë sekrete në zbatim të LPP që të mos njoftohemi për shkakun dhe arsyen e skualifikimit. Rrjedhimisht jemi në kushtet e një vendimi të pa arsyetuar të KVO. Ky vendim absolutisht të drejton drejt një ankimi të ri të cilin po e lexoni dhe shqyrtoni, i cili po sjell vonesën në realizmin e shërbimit aq të nevojshëm për turizmin shqiptar. Mund të mendoni se operatorët ekonomik janë tregtar dhe nuk shohin përtej fitimit të tyre, por duhet të dini që janë edhe shqiptar dhe e duan këtë vend përkundërt veprimit tuaj që nuk po e marrim vesh se ku do të dalë, por është kryekëput kundër politikave kombëtare të turizmit si një sektor strategjik për ekonominë e vendit. Të nderuar anëtarë të KVO ju ftoj që edhe nëse nuk dini, të pyesni si realizohet arsyetimi i një vendimi për skualifikim në mënyrë që të paktën formalisht të legjitimoni paligjshmërinë tuaj. Kohët e fundit rregullisht dëgjojmë që nëse nuk jepet vendim në favorin e njërës nga palët në mosmarrëveshje, pala humbëse ulëret që do ti drejtohem organeve ligjzbatuese dhe realisht me duket intimiduese ndaj administratës e cila duhet të bëjë punën e saj e qetë dhe e motivuar, duke zbatuar ligjin. Në rastin konkret Ju garantoj që do të ndjek çdo shkallë ankimi administrativ, gjyqësor dhe penal për të mbrojtur të drejtën time, në zbatim të ligjit, sepse me keni kualifikuar dhe pas vendimit të KPP-së Nr. 334/2019, datë 03.06.2019, në të cilin është vendosur pranimi i ankimit tim për lotin e II-të, më s’kualifikoni për një arsye që e dini vetëm ju dhe dreqi, a kushdo tjetër, por mua nuk më është dhënë mundësia ta di në asnjë lloj forme të parashikuar nga ligji. [...]”

II.11. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 755/41 Prot. datë 24.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., duke mos pranuar ankesën e tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

“Sipas vendimit me nr. 334, datë 03.06.2019, të Komisioni të Prokurimit Publik, lidhur me Lotin e II-të, me objekt “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës” është pranuar ankimi Juaj për skualifikimin e Operatorit Ekonomik “AKADEMIA SHËNDETIT PUBLIK”, vendim i cili është zbatuar nga Autoriteti Kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.

Në datën 02.05.2019, ISHP-ja është njohur me shkresën nr. 1986/1 prot., datë 26.04.2019, të Njesisë së Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, me anë të së cilës është përcjellë relacioni i tyre, për procedurën e prokurimit me objekt, “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane e ndarë në 4 (katër) lote. Në relacionin e Njesisë së Transparencës dhe Antikorrupsionit për lotin e 2-të, në përfundim është rekomanduar: ”Rishikimi i vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimet e operatorëve ekonomikë në lotin e 2-të, konkretisht të OE të renditur në vend të parë dhe të dytë ”Akademia e Shëndetit Publik”

sh.p.k. dhe "Fatos Lashi" pf, duke skualifikuar të dy këta operatorë ekonomikë të kualifikuar dhe duke mbetur i kualifikuar vetëm operatori NRG shpk.

Sa më sipër, AK-ja, mbështetur në nenin 64/2, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar se "Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve "nga marrja dijeni për vendimin", ka informuar KPP-në me shkresën nr. 755/7 prot., datë 06.06.2019 "Kërkesë për udhëzimin e ISHP për mënyrën e zbatimit të Vendimit nr. 334/2019, datë 03.06.2019, të Komisionit të Prokurimit Publik", se ISHP-ja ndodhet përpara pamundësisë së zbatimit të vendimit të dhënë nga KPP-ja për shkak të një vendimi tjetër të ndërmarrë nga Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit për të njëjtën procedurë (LOTIN 2: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës"), duke i kërkuar edhe udhëzimin e ISHP-së për veprimet që duhet të ndërmarrë në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 334/2019, datë 03.06.2019, të KPP-së të dhënë për Lotin i II-të: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës", me qëllim vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Gjithashtu. ISHP-ja i është drejtuar edhe APP-së dhe Njesisë së Transparencës dhe Antikorrupsionit, përkatësisht me shkresat e mëposhtme: APP-së me shkresën nr. 755/8 prot., datë 06.06.2019 "Kërkesë për këshillim dhe asistencë ligjore", për sa shpjegojmë më sipër për këtë LOT, duke sjellë në vëmendje të tyre se, APP-ja me shkresën nr. 3668/1 prot., datë 10.05.2019 "Kërkesë për dërgim informacioni dokumentacioni" i është drejtuar ISHP për t'i vendosur në dispozicion dokumentet dhe informacion në lidhje me OE "Fatos Lashi" p.f., bazuar në relacionin e përgatitur nga Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri. Informacioni i kërkuar i është përcjellë me shkresën nr. 585/19 prot., datë 16.05.2019. ISHP-ja në këtë shkresë i ka kërkuar të na bëjnë me dijeni në lidhje me vendimin e tyre për OE "Fatos Lashi" p.f., me qëllim që AK, ISHP në marrjen e vendimit të tij në hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm.

Njesisë së Transparencës dhe Antikorrupsionit me shkresën nr. 755/9 prot., datë 06.06.2019 "Kërkesë për rishqyrtim të rekomandimeve të lëna nga Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri", duke i kërkuar rishqyrtimin e rekomandimeve të lëna për Lotin e II-të të kësaj procedure prokurimi, bazuar edhe në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se "Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në ushën e prokurimve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj si dhe në pikën 2 të nenit -19/7 të po këtij ligji ku citohet se "Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përbundimtare. APP-ja është përgjegjës me shkresën nr. 3668/3, datë 07.06.2019 "Kërkesë për dërgim informacioni dokumentacioni", protokolluar me Tonën nr. 585/20 prot., datë 10.06.2019, në të cilën shprehet se "Duke qenë se Departamenti i Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit në relacionin e dërguar pranë APP-së, ngre pretendime mbi certifikatën e regjistrimit të produktit Aquabac në Francë, në të cilën gjatë përkthimit në gjuhën shqipe është bërë shtesë krahasuar me origjinalin, APP, për të gjykuar nëse ndodhet në kushtet e nenit 13/3/a të LPP, kërkon nga AK-ja juaj të verifikojë vërtetësinë e certifikatës së origjinës për produktin Aquabac në Francë të paraqitur nga OE "FATOS LASHI" pf në procedurën e prokurimit të sipërcituar.....

Deri më sot, pranë ISHP-së nuk ka ardhur asnjë përgjigje nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit për shkresat e drejtuara nga ISHP-ja. Ndërkohë që nga data 12.04.2019, ISHP-ja ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për përdormin e lëndës Aquabac në këtë procedurë prokurimi. Në datën 03.06.2019, Instituti i Shëndetit Publik i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 755/1 prot., datë 03.06.2019 “Vendimmarrje nga ana Juaj. Kthim përgjigjeje shkresës Suaj me nr. 2940 prot., datë 30.05.2019”, në lidhje me përdorimin e produktit Aquabac në procesin e dezinfektimit. Në datën 12.06.2019, në protokollin e Institutit të Shëndetit Publik është depozituar shkresa me nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 “Anullim i Autorizimit të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G”, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, protokolluar me Tonën nr. 755/12 prot., datë 12.06.2019, për njoftimin e Institutit të Shëndetit Publik për anulimin e Autorizimit të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G”, shkresë të cilën ia kemi përcjellë edhe OE “FATOS LASHI” p.f me shkresën nr. 755/25, datë 17.06.2019. Në zbatim të shkresës së sipërcituar, Autoriteti Kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik ka skualifikuar të gjithë operatorët ekonomikë të cilët kanë ofertuar me lëndën Aquabac, në secilin prej Loteve të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”. Si pasojë, OE “FATOS LASHI” p. f është skualifikuar në Lotin e II-të dhe Lotin e IV-t të kësaj procedure prokurimi.

Sa më sipër, SUBJEKTI “FATOS LASHI” është SKUALIFIKUAR bazuar në Shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 “Anullim i Autorizimit të Importit/për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G”, për arsye të mospërmbushjes së kriterit 3, kapaciteti teknik, të Dokumenteve Standarde të Tenderit për Lotin e II-të, se “Në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, OE duhet të paraqesë etiketat dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuar sipas loteve. Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese të duhet të përdoren: a Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Btz) mikrogranula të tretshme në ujë (WG) me fuqi 3000 I.T.U. mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare), b) Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) granular (G) me fuqi 200 I.T.U për mg, c) Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqëndrimin 1ml/m² .”

Për sa më sipër, pretendimet e OE “PATOS LASHI” nuk qëndrojnë dhe kërkesa e tij nuk pranohet.”

II.12.Në datën 27.06.2019, operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Me datë 13.06.2019 nëpërmjet njoftimit në SPE, operatori ekonomik ankimues, njoftohet se është skualifikuar në zbatim të shkresës Nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me datë 14.06.2019 i jemi drejtuar Autoritetit Kontraktor me kërkesë ankimore që në zbatim të Vendimit Nr. 334/2019, datë 03.06.2019 të shpallte

fitues OE "Fatos Lashi" p.f. si OE i kualifikuar me vlerën më të ulët të ofertës, gjithashtu të sqaronte edhe arsyen e skualifikimit. Arsyeja e kërimit të dytë në kërkesën me sipër ishte, sepse përveç citimit të numrit dhe datës së shkresës (Nr. 3159 prot., datë 11.06.2019 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), nuk na u bë e ditur përmbajtja e saj e cila kishte çuar në skualifikimin e OE "Fatos Lashi" p.f.. Pra ishim në kushtet e një vendimi arbitrar të pa arsyetuar.

Pergjigja per arsyen e s'kualifikimit erdhi me shkresën Nr. 755/25 Prot., datë 17.06.2019 "Njoftim vendimi". Në këtë njoftim AK është shprehur, se:

1. Eshtë zbatuar Vendimi Nr. 334/2019, datë 03.06.2019 i Komisionit të Prokurimit Publik duke S'kualifikuar operatorin ekonomik "Akademia e Shëndetit Publik" sh.p.k.

2. Me datë 03.06.2019, Instituti i Shëndetit Publik i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 755 Prot., datë 03.06.2019 "Vendimarrje nga ana Juaj. Kthim përgjigje shkresës Suaj me nr. 2940 Prot., datë 30.05.2019", në lidhje me përdorimin e produktit Aquabac në procesin e dezinfektimit.

3. Me datën 12.06.2019 në protokollin e ISHP është depozituar shkresa me Nr. 3159 Prot., datë 11.06.2019, "Anullim i Autorizimit të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G", nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me Nr. 755/12 Prot., për njoftimin e ISHP për Anullimin e Autorizimit të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G.

4. Në zbatim të shkresës së sipërcituar ISHP në rolin e AK ka s'kualifikuar të gjithë operatorët: ekonomikë të cilët kanë ofertuar me lëndën Aquabac, në secilin prej loteve të procedurës së prokurimit me objekt: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane". Vendimi i AK për s'kualifikimin e OE "Fatos Lashi" p.f. në Lotin e II-të dhe Lotin e IV-t, të procedurës së prokurimit me objekt: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane", është hapatazi në kundërshtim me LPP dhe aktet në zbatim të tij.

Konkretisht: OE "Fatos Lashi" p.f. është ankuar brenda afatit ligjor për skualifikimin nga Loti i II-të me datë 14.06.2019 dhe përgjigja për ankesën mban datën 24.06.2019, në kundërshtim me parashikimin e nenit 63, pika 5 të LPP, në të cilin është përcaktuar, se: "Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës." Mos zbatimi i Vendimit Nr. 334/2019, datë 03.06.2019 të Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/1, pika 1 dhe 19/7, pika 2, në të cilët përkatësisht është përcaktuar, se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj." dhe "...2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare." Eshtë shumë e çuditshme që vetë autoriteti kontraktor i citon këto parashikime dhe nuk i zbaton. Si mund të prevalojë një rekomandim i një organi të administratës (Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri), qoftë edhe organ epror, përmbi normat e miratuara nga ligjvënësi për të rregulluar fushën e prokurimeve publike!!! Por nuk është vetëm rekomandimi që tejkalon Ligjin, kemi edhe një Anullim Autorizimi të Importit për Produktet Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili tejkalon zbatueshmërinë e një akti të nxjerrë nga organi më i lartë në fushën e prokurimeve vendimet e të cilit janë

administrativisht përfundimtare. Autoriteti Kontraktor me mos veprimin e tij, duke mos zbatuar Vendimin Nr. 334/2019, datë 03.06.2019 të Komisionit të Prokurimit Publik ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit Neni 64/2. pika 2, në të cilin është përcaktuar, se: “2. Autoritetet kontraktore duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin. Nëse këto veprime i kanë sjellë efektet e tyre. atëherë Komisioni i Prokurimit Publik u këshillon personave të dëmtuar të ngrenë padi në gjykatë ose të bëjnë kallëzim penal.” Në kundërshtim me parashikimin e kësaj dispozite AK, jo vetëm nuk e ka zbatuar vendimin e KPP brenda afatit ligjor, nuk ka kërkuar as rishikimin e tij, por është drejtuar këtij organi me kërkesë për udhëzime. Në lidhje me shkakun determinant të s’kualifikimit të OE “Fatos Lashi” p.f, i cili AK pretendon se është mospërmbushja e kriterit 3., kapaciteti teknik të DST, ju sqarojmë se nuk qendron për arsyet e mëposhtme:

Në DST. pika 3. Kapaciteti teknik, është kërkuar në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, OE duhet të paraqesë etiketat dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuar sipas loteve.

Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

a. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) mikrogranula të tretshme në ujë (WG) me fuqi 3000 I.T.U. mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).

b. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) granular (G) me fuqi 200 I.T.U për mg.

c. Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqëndrimin 1ml m2.

Ndërsa në pikën 4 është kërkuar që OE duhet të paraqesë certifikatën e rregjistrimit të produkteve biocide Bli WG dhe Bli G, në një prej vendeve të Bashkimit Europian ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjencia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatat në Evropë).

Produkti i ofertuar nga OE “Fatos Lashi” p.f, është i prodhuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i regjistruar atje, pavarësisht se diskutohet për çertifikatë regjistrimi në Francë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Preparati është i regjistruar në shumë vende të Bashkimit Europian. Instituti i Shëndetit Publik zotëron kapacitetet e duhura për të vërtetuar këtë. Realisht për një ekspertizë të specializuar për të tilla raste është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ajo e cila angazhon ISHP, ndërsa në rastin konkret ka ndodhur e kundërta. Nëse këto produkte nuk do të kishin qenë ndërkombëtarisht të çertifikuara pse nuk u s’kualifikua OE që gjatë vlerësimit fillestar për këtë shkak. Rrjedhimisht produkti Aquabac i plotëson kushtet e kërkuara nga AK në DST. Bashkëngjitur po ju dërgojmë Çertifikatën e Regjistrimit në SHBA, sepse AK përpara s’kualifikoi OE dhe pastaj na njoftoi shkakun me përgjigjen dhënë ankesës sonë drejtuar ISHP. Ndërkohë që kishte çdo mundësi që të njoftonte shkakun dhe të kërkonte sqarime. Në përgjigjen e ankesës sonë për Lotin e II-të, AK shprehet se për këtë arsye jemi s’kualifikuar edhe nga Loti IV-t. Ndërkohë jemi njoftuar për anulimin e Lotit IV-t dhe i jemi drejtuar me ankesë të veçantë AK, sepse ka cituar si arsye anulimi vetëm parashikimin e nenit 24, pika 1, shkronja a : për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës

së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullatë prokurimit publik; [...]”

II.13. Në datën 05.07.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.955/1prot., datë 04.07.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, KPP vlerëson të ndalet dhe të sqarojë paqartësitë e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., lidhur me zbatueshmërinë dhe efektet ligjore të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik K.P.P. 334/2019.

III.1.1. Me anë të Vendimit K.P.P. 334/2019, datë 03.06.2019, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si më poshtë vijon:

“1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f për procedurën e prokurimit me Nr.REF-11181-02-28-2019, me objekt: “LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, duke e s’kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik”

III.1.2. Në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrtton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Komisioni i Prokurimit Publik në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare”.

III.1.3. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.4. Në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 20 “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, përcaktohet se:

“1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

- a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;
- b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi
- c) Bazën ligjore;
- d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;
- f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;
- g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

- a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;
- b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;
- c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.”.

III.1.5. Në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 26 “Verifikimi i kushteve formale”, përcaktohet se:

1. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 5 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b) legjitimimin e ankuesit;

c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d) elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 20 të kësaj rregulloreje. [...]”.

III.1.6.Në VKM nr. 261, datë 17.03.2010 “Për caktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, pika 4, përcaktohet shprehimisht: “Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e tij përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja.

III.1.7.Sa më sipër, sqarojmë se Komisioni i Prokurimit Publik vihet në lëvizje vetëm nga ankesat e paraqitura pranë tij dhe kur përmbushin kushtet formale të përcaktuara në bazën ligjore si më sipër cituar, pasi procedura para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, që do të thotë se KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave kryesisht, apo të hetojë dhe shqyrtojë jashtë objektit të ankesës. Si rregull, investimi i KPP është i kufizuar nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar dhe që plotësojnë kushtet formale sipas nenit 26 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Pra, objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes në Vendimin K.P.P. 334/2019, datë 03.06.2019, ka qënë ligjshmëria e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. dhe jo rivlerësimi i ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f. Në dispozitivin e Vendimit K.P.P. 334/2019, datë 03.06.2019, është vendosur qartë që autoriteti kontraktor duhet të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Vendim i cili, nga verifikimet e kryera, rezulton se është zbatuar nga autoriteti kontraktor me anë të rivlerësimit datë 13.06.2019.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f. mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin: “[...]Në DST. pika 3. Kapaciteti teknik, është kërkuar në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, OE duhet të paraqesë etiketat dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuara sipas loteve.

Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

a. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) mikrogranula të tretshme në ujë (WG) me fuqi 3000 I.T.U. mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).

b. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) granular (G) me fuqi 200 I.T.U për mg.

c. Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml m2.

Ndërsa në pikën 4 është kërkuar që OE duhet të paraqesë certifikatën e rregjistrimit të produkteve biocide Bli WG dhe Bli G, në një prej vendeve të Bashkimit European ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjensia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë). Produkti i ofertuar nga OE “Fatos Lashi” p.f, është i prodhuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i regjistruar atje, pavarësisht se diskutohet për certifikatë regjistrimi në Francë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Preparati është i regjistruar në shumë vende të Bashkimit European. Instituti i Shëndetit Publik zotëron kapacitetet e duhura për të vërtetuar këtë. Realisht për një ekspertizë të specializuar për të tilla raste është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ajo e cila angazhon ISHP, ndërsa në rastin konkret ka ndodhur e kundërta. Nëse këto produkte nuk do të kishin qenë ndërkombtarisht të certifikuara pse nuk u s’kualifikua OE që gjatë vlerësimit fillestar për këtë shkak. Rrjedhimisht produkti Aquabac i plotëson kushtet e kërkuara nga AK në DST. Bashkëngjitur po ju dërgojmë Çertifikatën e Regjistrimit në SHBA, sepse AK përpara s’kualifikoi OE dhe pastaj na njoftoi shkakun me përgjigjen dhënë ankesës sonë drejtuar ISHP. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën nr. 8 (Loti II), pikat 3 dhe 4, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“3.Në lidhje me lëndët dezinfektuese që do të përdoret në trajtim sipas formulimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, OE duhet të paraqesë etiketat dhe Dokumentacionin me të Dhënat e Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuara sipas loteve.

Formulimet dhe përqëndrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

a.Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) mikrogranula të tretshme në ujë (WG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).

b.Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) granular (G) me fuqi 200 I.T.U për mg.

c.Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml/m2.

4.OE duhet të paraqesë certifikatën e rregjistrimit të produkteve biocide Bti WG dhe Bti G, në një prej vendeve të Bashkimit European ose në Angli, Zvicër, Kanada, Australi, dhe SHBA të regjistruar në ECHA (Agjensia Evropiane e Kimikateve, organi më i madh për kimikatet në Evropë). ”

III.2.2.Në datën 02.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------------------------|
| 1. “Air” sh.p.k. & “Truly Nolen” d.sh.h | 34.149 lekë, skualifikuar |
| 2. “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. | 43.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Fatos Lashi” p.f. | 47.406 lekë, kualifikuar |
| 4. “NRG” sh.p.k. | 50.410 lekë, kualifikuar |

III.2.3.Në datën 13.06.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------------------------|
| 1. “Air” sh.p.k. & “Truly Nolen” d.sh.h | 34.149 lekë, skualifikuar |
| 2. “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. | 43.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Fatos Lashi” p.f. | 47.406 lekë, skualifikuar |
| 4. “NRG” sh.p.k. | 50.410 lekë, kualifikuar |

III.2.4. Në datën 13.06.2019, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Fatos Lashi” p.f. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Bazuar në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 3159 prot., datë 11.06.2019.”

III.2.5.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.6.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga hetimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezultoi se në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., ka paraqitur Certifikatën e regjistrimit të produkteve biocide Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G, lëshuar në datën 30.06.2016, nga Ministria Franceze e Mjedisit Energjisë dhe Detit, për llogari të subjektit CERA SAS.

III.2.7.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezultoi se me anë të shkresës nr.3159prot., datë 11.06.2019, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, autoriteti kontraktor është vënë në dijeni se ka anuluar autorizimin e importit të produkteve biocide Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G, lëshuar në bazë të certifikatës të regjistrimit të lëshuar për kompaninë CERA SAS Francë, pasi nga verifikimi i kryer nga Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide, rezultoi se certifikata e mësipërme është anuluar në Francë me vendimin e datës 29.06.2018.

III.2.8.Referuar sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e shërbimit objekt prokurimi, interesin publik, impaktin në shëndetin e qytetarëve, marrë indicie edhe nga shkresa nr.3159prot., datë 11.06.2019 e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Prokurimit Publik, pas verifikimeve të kryera, konstatoi se për Certifikatën e regjistrimit të produkteve biocide Aquabac DF 3000 dhe Aquabac 200G, lëshuar në datën 30.06.2016, nga Ministria Franceze e Mjedisit Energjisë dhe Detit, për llogari të subjektit CERA SAS, Gjykata Administrative e Parisit me anë të vendimit nr. 1616903 / 4-2 datë 29.06.2018, ka shpallur pavlefshmërinë e vendimit të Ministrit Francez të Mjedisit Energjisë dhe Detit, për regjistrimin e produkteve Aquabac XT, Aquabac DF3000 dhe Aquabac 200G, për llogari të subjektit CERA SAS, e për rrjedhojë edhe të certifikatës të regjistrimit të këtyre produkteve, vendim i cili është lënë në fuqi me Vendimin e datës 21.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Paris.

III.2.9.Në këto kushte, Komisioni konstaton se, operatori ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f., për produktet biocide të cilat janë ofruar nga ky i fundit për zbatimin e kontratës objekt prokurimi, ka paraqitur një certifikatë regjistrimi të pavlefshme në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni gjykon se, pavarësisht faktit që KVO nuk e ka konstatuar këtë pavlefshmëri dokumenti gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, kjo nuk e zhbën faktin që operatori ekonomik ka paraqitur një dokument të pavlefshëm lidhur me produkte shumë sensitive dhe me ndikim potencialisht të rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor është përgjegjësi kryesor, për menaxhimin e fondeve publike me eficence, zhvillimin e procedurës së prokurimit në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, si dhe zbatimin me sukses të kontratës brenda afatit kohor të përcaktuar dhe në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.

III.2.10.Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, duhet të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 53/3 të LPP-së dhe të parimit të barazisë lidhur me vlerësimin e ofertave. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë

prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e shërbimit objekt prokurimi, interesin publik, impaktin në shëndetin e qytetarëve, rrethanat e reja të cilat mund të mos jenë njohur gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nga KVO, parimin e efikasitetit dhe ligjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike, Komisioni gjykon se, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 8 (Loti II), pikat 3 dhe 4, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, është i drejtë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Fatos Lashi” p.f. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt “LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”, me nr. REF-11181-02-28-2019, me vlerë të pritshme të kontratave për 2 vjet 43,593,744 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1162 protokolli Datë 27.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha